

BURHAN KUKELI

Lulishtari plak

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-32

K93



TREGIME DHE SKICA

8JH-32
K98.

BURHAN KUKELI

LULISHTARI PLAK

Tregime dhe skica



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

Redaktore: Lumturi Prizreni

Piktor: Svetllana Strazimiri

Tirazhi 5 000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1974

FUNDI I NJË RRUGE

Në muajin e dytë të pranverës për tri ditë me radhë fryu një erë e ngrohtë, e vrullshme, që erdhi nga Jugu, ndërsa aty nga mesi i ditës së tretë nisi të binte shi, një shi i dendur, me pikë të mëdha. Malet dukeshin si të mjegulluara. Shiu ia kishte zënë shtruar dhe s'kishte ndër mend të pu-shonte.

Atë muaj punoja tranzit, transportoja mineral nga një minierë e Veriut për në qytetin e ri të Lاقit. Isha ulur në restorantin e stacionit të trenit dhe prisja të më sillnin porosinë. Më kishte mbërthyer një dremitje e tillë, që nuk e përcaktoja dot se nga se e kisha. Ndoshta nga lodhja, apo ndoshta dhe nga moti. Ah, këto ditët me shi sikur të kapisin, sikur...

Rija ulur. Jashtë shiu fërgëllonte dhe rrihte me zhurmë xhamet e dritareve të mëdha. Në sallë ishte ngrohtë.

S'e ndjeva kur u hap dera, por rryma e ftohtë e ajrit që hyri, më bëri të rrëqethesha, ndaj ktheva kokën dhe vura re që hyri një i njojuri im, Jani. Mante veshur një xhaketë të zezë prej lëkure, si ato që mbajmë zakonisht ne, shoferët. Fytyra e tij e

freskët kishte ngjyrën e broncit, sytë e tij të kaltër ishin të butë dhe me një vështrim të qeshur.

Më kishte parë dhe po vinte drejt meje. U çova dhe, si e përshëndeta, e ftova të ulej.

— Si je, Jan? — e pyeta duke i shtrirë dorën.

— Në rregull, po ti, usta, ç'bën? — ma ktheu dhe, si u ul, shtoi: — Po kthehem atje....

— Mirë bën — i thashë. — Po babai ç'tha?

— Babai? Në fillim s'deshi të më linte. I erdhi keq kur ia thashë vendimin tim. E di, usta, mua më pëlqyen miniera e sidomos njerëzit e saj të fuqishëm që çdo ditë përleshën me malin dhe e mposhtin, vështrimi i tyre i ëmbël e miqësor, bisedat e tyre plot humor e gjallëri, ndaj vendosa të mbetesha atje, pranë tyre.

E vështrova në sy djaloshin dhe për habi sytë e tij m'u dukën më të ciltër, më të qeshur, më të vendosur.

«Ky djalë është shëruar plotësisht», mendova.

* * *

S'kishim shumë kohë që ishim njohur. E kisha parë këtë djalë shtatlartë dhe bjond tek vinte rrrotull nëpër sheshin e vogël para minierës, atje ku nxinin grumbuj të mëdhenj minerali, atje, ku vagonët hyrin e dilnin me gërvimë që nga goja e galerisë deri te klubi i vogël. Me një fjalë u njoha në minierë.

Një ditë, kur sapo kisha ngarkuar dhe po bëhesha gati të nisësha, vura re djaloshin të ma bënte me dorë nga larg dhe pas pak e pashë të vraponë drejt meje.

— Usta, do të më marrësh? — më tha kur m'u afroa.

— Për ku?

— Për në Laç. Dua të shkoj në Tiranë — dhe m'i nguli sytë. Vura re se ata ishin të kaltër, por pak si të mjegulluar. Djaloshi sikur vuante. Ç'të kishte?

Hapa derën e makinës. Pas pak ajo nisi të shkiste rrugës gjarpërore.

Ca kohë udhëtuam në heshtje. I pari fola unë. Kështu e kemi ne, shoferat, s'rrimë dot pa folur, pa pyetur. S'kemi faj, se me anë të këtyre bisedave më-



sojmë mbi jetën që zien anembanë e që ne jemi të detyruar ta vështrojmë nëpërmjet katërkëndëshit të xhamtë të kabinës.

— Keni ardhur me punë këtu në minierë?

— Jo, jo — m'u përgjigj. — Kam ardhur mik. Kam xhaxhanë.

— Cili është xhaxhai yt??

— Vasili, besoj se e njihni.

— Vasilin? Xha Vasilin? Mos, more! Qenke nipi i tij! Ah, ç'burrë që është! — thirra unë.

Me atë fytyrë të ashpër e tërë rrudha, me atë kurorë të bardhë flokësh, me sytë e tij të zinj, të gjallë, të fshehur në vetullat kaleshe, xha Vasili më kujtonë një bust punëtori që kisha parë dikur në galerinë e arteve. Kishte vite që ai ishte vendosur në këtë qytet të vogël minatorësh. Ishte një punëtor i mirë, i palodhur, i dashur. Ndaj të tërë e donin dhe e respektonin. Madje nga kjo shokët e kishin zgjedhur dhe sekretar të organizatës bazë të partisë.

— Dhe ti erdhe të pushosh disa ditë te xhaxhai.

— Herën e fundit, kur qe te ne në shtëpi, më mori me vete.

— Po babanë si ta quajnë? — vazhdova unë, me kuriozitetin e shoferit.

— Babanë tim e quajnë Llukan.

— Ku punon?

— Punon në Tiranë, në një dikaster qëndror. Unë jam fëmija i fundit pas dy motrave. Thonë se, kur linda unë, për tri net me radhë shtëpia jonë ishte në festë, të ftuarit nuk kishin të sosur dhe kërciste muzika, zbrazeshin shishet e rakisë dhe vlonët urimi i zakonshëm: «T'ju rrojë djali! Me jetë të gjatë, shoku Llukan».

Pra, unë isha shpresa e babait, isha e tërëjeta e tij. E di, kishte ditë që fytyrat e pjesëtarëve të familjes sime ishin të ngrysura si qelli i dimrit, e kjo donte të thoshte se unë nuk isha mirë. Isha bërë pra një barometër shpirtëror i prindërve...

«Pushoni, mos bëni zhurmë, po fle djali...»

Dhe ata e vinin gishtin tregues mbi buzët, në shenjë që të mbahej qetësia. Kështu u rrita unë.

Këtu djaloshi heshti për pak çaste. Sytë e tij të kaltërt dukeshin èndërrimtarë. Më zgjati paqetën e duhanit.

— Ndezim nga një.

— Jo, falemnderit, s'e pi dot me filtër.

Tej xhameve të kabinës, shtrihej rruga e tutje, anash, fusha e madhe pa mbarim. Kishte qenë kënetë ajo, dikur. Dukeshin e zhdukeshin silueta kalimtarësh që nxitonin. Disa herë u dëgjua fishkëllima e trenit.

—... Kështu u rrita, — e prishi heshtjen djaloshi tek thithje thellë cigaren që e mbante në grusht — u rrita në mes të të mirave. Të gjitha dëshirat dhe tekat më plotësoheshin në çast. Hyra edhe unë në jetë pra, por jo si të gjithë. Kisha zënë një vend në trotuarin pranë MAPO-s dhe atje kaloja orë të tëra. Ndërsa moshatari është mi mësonin ose dhe punonin, unë ngacmoja vajzat që kalonin rrugës në punë të tyre. Babai vazhdonte të kuwendonte mbrëmjeve me nënën përmes mua, për cilësitë e rralla që kisha, për talentin tim (se, q'është e vërteta, kisha shkruar në vitet e para të gjimnazit ndonjë vjershë).

«Eshtë i zgjuar, Janushi ynë. Poet do të bëhet. Dhe çfarë poeti i dëgjuar! Ja, sivjet mbaron të messmen dhe të përpinqemi ta futim të studjojë për letërsi.»

Këtu djaloshi qeshi i skuqur, ndoshta ngaqë i erdhi rëndë. Nga dritarja gjysmë e hapur e flaku tej cigaren ende të pa mbaruar mirë.

«... Kështu fliste gjithnjë babai, sepse ai s'e dinte që unë maturën nuk do ta merrja, ndonëse shkathëtësia dhe miqësitetë e shumta të tij sikur m'i përkëchelnin ëndrrat. Bota ime kishte filluar të zvogëlohej, nuk shihja asgjë përveç vetes sime. Isha mësuar të prisja gjithçka nga babai, ashtu sikurse shpresoja se edhe maturën, edhe të drejtën e studimit pér në universitet do të m'i siguronte ai. Mirëpo nuk arrita as në vjeshtë ta merrja maturën, kështu që mbeta rrugëve pa punë dhe pa shkollë. Shokët e mi u rregulluan. Kush filloi studimet e kush hyri në punë. Mbata i vetëm. Kjo gjë filloi të më mërziste dhe u bëra i zyrtë. Babai megjithatë shpresonte ende.

«Mos u mërzit, Janush! mundohej të ma largente mërinë babai. — Do të të rregullojmë në ndonjë zyrë.» Ditët kalonin dhe unë i vetëm sillesha vazarit. Shokët e mi me kohë kishin filluar nëpër uzina e kantiere... Por babait e aq më shumë mua nuk na pëlgente puna fizike. Vërtet që dikur im atë kisha qenë punëtor, marangoz, por tani ama, ai ishte, me duar të buta dhe muskuj të ronitur. Bota ime e përkëdhelur nuk më linte të shihja as motrat. Ato ishin të mira e të sjellshme. Vjola, motra e madhe, punonte në uzinë. Dhe ishte punëtore pararojë. Ato ditë ishte pranuar në parti, ndërsa Ida studjonte pér mjeke.

Një mbrëmje ishim mbledhur rrëth tryezës. Hanim dhe bisedonim. Ishte vapë, prandaj kishim hapur dritaren. Shtëpinë tonë e kemi në periferi të qytetit. Frynte një fllad i freskët. Nga jashtë vinte zhurma e fëmijëve që loznin ende. Atë mbrëmje

nuk ndjehesha mirë. Më dhembte koka. Ndjehesha i lodhur. Si duket ishin shkaqet e bisedës me Agronin. «Agronin e kam pasur shok klase. Bashkë vazhduam deri në maturë. Atë e kishim dhe sekretar rinie. Kur mbaruam shkollën, ndërsa unë mbeta, atij i doli e drejta e studimit për në Fakultetin e Inxhinierisë.

Më pyeti c'bëja, ku isha me punë, e, kur i thashë se sillesha kot vërdallë me shpresë se mos rregullohesha në ndonjë zyrë, ai s'u përbajt më dhe shpërtheu:

«Mendoja se kam të bëj me një djalë të pjekur dhe jo me një «djalkë» mamaje. Kështu si sillesh ti, s'nderon as veten, as ne, shokët e tu. Madje habitem edhe me qëndrimin e familjes sate.»

«E c'mendoj dhe unë. Punë e madhe se tha Agroni ashtu». U mundova ta harroja atë bisedë. Ndaj desha të haja, por edhe buka s'më shkonte. Pashë babanë që hante në heshtje dhe herë pas here më hidhte vështrime përkëdhëllëse. Nëna, e urtë si gjithnjë, ishte ulur pranë vajzave. Se c'fliste me zë të ulët me Idën, motrën e vogël. Pjata ime kishte mbetur e paprekur. Nuk kisha oreks. Babai e vuri re. Fytyra e tij buçkane u drodh.

« —Janush! Përse nuk po ha? — pyeti i shqetësuar.

— Nuk jam mirë, baba! — iu përgjigja.

— T'i telefonoj mjekut? — më pyeti.

Vjola u skuq. Duket se dicka i vlonë përbrenda. ndaj, si më hodhi një vështrim të shpejtë, shpërtheu:

— Baba, ai nuk ka asgjë përvëç dembelizmit.

E vështrova Vjolën.

— Aaa! Kur kështu ti? — u habit babai. — Ç'është kështu?

Ai e la lugën, sytë iu shqetësuan dhe i foli me zemërim motrës së madhe.

— Vjen tjetri i lodhur nga puna në vend që të hajë rehat, i duhet dhe të zihet.

— Të gjithë lodhemi. Edhe nëna lodhet. Vetëm Jani, djalka i babait, s'djersin — foli ajo me ironi.

Për çudi vura re se edhe nëna ishte e zemëruar me mua. «Sot qenkan të gjithë me nerva», mendova.

E kuptoja fare mirë se ato kishin të drejtë, se unë, djalë në moshë, diçka duhej të bëja. Po s'ishte e lehtë ta pohoja këtë gjë unë, i preferuari i babait, unë, aq shumë i përkëdhelur.

Ditët sa vinin e bëheshin më të padurueshme. Një mbrëmje, ndërsa po kthehesha në shtëpi, takova kryetarin e këshillit, i cili me marifet ma solli fjalën te sorollatjet e mia. E ndjeva që u skuqa, sepse filuan të më digjnin veshët. «Kështu si sillesh ti, turpëron jo vetëm familjen, por edhe lagjen dhe socializmin». E ndjeja veten të dërmuar. Por kulmi arriti kur hyra në shtëpi. Ida, kur më pa që hyra, tha:

— Erdhi poeti i babait!

Unë i inatosur e qëllova me shuplakë. Grindja arriti kulmin. Babai mundohej të më mbronte, ndërsa nëna dhe motrat nuk përbaheshin më.

— S'ke turp — më tha Vjola dhe më vështroi me inat. — S'ke faj ti, jo, kur të mbron babai.

Ida ishte struktur në një qoshe dhe qante në heشتje.

— Nuk ke faj ti, jo. Fajin e ke ti, Llukan, që e harbove fare këtë djalë. Dhe dëgjo ti, — m'u drejtua mua — vajzat mos m'i nga! — Zëri nënës i dilte i dridhur, fjalët i lidhte me vështirësi, fytyra e saj m'u duk më e zbetë.

Babai s'foli më, por u ngrit dhe vajti në dho-

mën e tij. Do të punonte. Ne rrnim të gjithë të heshtur e si të mpirë. E pashë veten ngushtë, ndaj u ngrita dhe vajta në dhomën time. Rashë të flija. Gjumi nuk më zinte. Më bëhej se dikush më shtrëngonte në grykë. Nga dhoma tjetër dëgjohej e kolitura e babait. Nuk më hiqeshin nga sytë fytyra e nënës. Vjola e revoltuar, lotët e Idës. Çudi me Vjolën. Ajo gjithnjë ka qenë e tillë, e guximshme. Asnjëherë nuk i ka duruar padrejtësitë. U ngrita dhe iu afrova dritäres. Nata ishte e qetë. Plepat e një parku aty pranë fëshférinin lehtë. Qielli vezullonte nga yjet. Tej, sa të hante syri, shtrihej Tirana. Qyteti i madh llamburiste nga dritat e panumërtë. Në ato orë të vona autobusat e rojes punonin ende. Nëpër arte-ret e mia, së bashku me gjakun, e ndjeja se më qarkullonte edhe pendimi. S'e di pse m'u kujtua një ngjarje, që në atë çast m'u duk qesharake. Më mirë të them marrëzi. Një ditë im atë më tha të paraqitesha në një ndërmarrje ndërtimi te shefi i kuadrit. Të nesërmen vajta në zyrën e shefit. Ai ishte një burrë i shkuar në moshë, thatim dhe miop. Më priti mirë. Siç duket ia mbushën syrin shpatullat e mia të gjera. Pa e zgjatur hyri drejt e në temë.

— Filloni qysh nesër — më tha — në brigadën e muratorëve. Do të bëheni një murator ju që... — Si u ngrit nga karrigia, m'u afroa dhe me buzë në gaz më rrahu shpatullat. Se si m'u duk atë çast ajo fytyra e tij thatime, pa shprehje, e largët dhe e zbetë si një maskë. Nuk i dhashë përgjigje, por mendjen amë kisha të mbledhur:

«Unë murator?!! Bah! Unë jam goxha djalë, i biri i Llukanit?! Pastaj duart e mia s'janë mësuar me punë. Nuk më shkon mua kjo punë.»

Sytë e shefit të kuadrit matanë lenteve të syze-

ve më vështronin me tallje. Si i urova «ditën e mirë», dola nga zyra...

I mbështetur mbi pezulin e drifores, qesha shumë me këtë ngjarje që s'di pse m'u kujtua sonte. Sa më ishte dhimsur vetja atë ditë. Ndërsa sot ndjehesha i dërmuar. Mendova të shkoja te nëna, ta zgjoja nga gjumi, t'i kërkoja të falur, t'i thosha se asnjetëherë nuk do të sillesha më si atë mbrëmje, por as këtë nuk e bëra.

Kushedil sa e sa kohë do të kishte vazhduar kjo gjendje, sikur të nesërmen, dy muaj e ca më parë, të mos kishte ardhur xhaxhai, Vasili. Babai kishte respekt për të vëllanë dhe këtë e shfaqte. Bota e tij e vogël bëhej ende dhe më e vogël para botës së madhe dhe plot shëndet të xhaxhait. Dhe ne, të tjerët, e donim dhe e respektonim atë. Pasioni, me të cilin fliste për minierën, për minatorët, të bënte përvete.

Babai u gëzua. Të dy vëllezërit nuk ishin parë prej një kohe të gjatë.

Si u përqafua me nënën dhe me motrat, u kthyen nga unë. Më vështroi si i habitur dhe, duke buzëqeshur, iu kthyen babait e i shkeli syrin.

— Eh, Llukan, djali të qenka bërë burrë! Qenke rritur goxha — m'u drejtua mua. — Pa të shohim sa i fortë je — dhe më përmblodhi për mesi. U mundova të mbahesha, por ai kishte krahë të fortë dhe më mposhti. Motrat qeshën, ndërsa unë e ndjeja vreten mjaft të fyter.

— I fortë qenka ky djalë! I fortë si një minator.

Pastaj u ulëm në tryezë. Atë natë ndenjëm deri vonë. Ai na foli, bëri shaka, tregoi mjaft anekdota dhe na bëri të qeshnim. Unë e harrova shakanë e parë, madje prania e tij bëri që në familjen tonë të

shkundej ajo zymtësi që kishte ca kohë që s'po na ndahej. Babai im aty qeshte, aty skuqeji në fytyrë dhe herë pas here ndizte cigaren që i shuhej. Nëna qeshte si një fëmijë, ndërsa Vjolës i ndrisnin sytë. Kur xhaxhai mori vesh se unë sillesha tërë ditën kot së koti pazarit, e këtë gjë ia tha Vjola, u vrenjt në fytyrë.

— Jo, Llukan, nuk bën mirë — i tha babait pas një heshtjeje të shkurtër. — Të gjithë kanë djem dhe ndoshta më të mirë se yti.

Unë ula kokën i turpëruar e s'fola fare. Biseda e tyre u ndez. E pashë xhaxhanë të nervozohej.

Natën tjetër ata hynë në dhomën e punës së babait. Zërat e tyre të nervozuar vinin deri në dhomën time.

— Nuk duhet vepruar kështu, Llukan. Tani ai është në moshë. Rruga e jetës është e gjatë. — Fjalët e tij vinin të rënda si gjëmime kambane.

— Është shumë i ri, bre Vaso, nuk dua që ai të argaset që tani. E kam djalë të vetëm, bre Vaso! — Zëri i babait vinte i butë dhe i shtruar.

— Në q'moshë e hodhe pushkën krahëve ti? Ishe më i ri nga yt bir, apo harrove?

— E po ndryshe ishim ne... — ia ktheu im atë.

Unë në dhomë fillova të dridhesha, nuk mund të dëgjoja më. Xhaxhai kishte të drejtë, por ama edhe babai kishte të drejtë. Unë e ndjeja veten fajtor. U vesha dhe dola në oborr. Fillova të endesha kot së koti përreth. Mendimet më vinin parreshtur, njëri pas tjetrit. Më ishte prishur qetësia, nuk ndjehesha mirë. «Diçka duhet bërë. Vjola, shokët, kryetari i këshillit dhe më në fund xhaxhai. Po, po, që nesër do të shkoj të kërkoj punë», vendosa dhe u ktheva në dhomë. Gjumin atë natë e bëra të shqetësuar.

* * *

Të nesërmen shëtita me xhaxhanë nëpër qytet. U ulëm në një lulishte. Pranë tij e ndjeja veten të gjëzuar, ndonëse nuk kisha guxim ta vështroja në sy. Në bulevardin e madh të kapur njëri pas tjetrit kalluan fëmijët e një kopshti. Ata këndonin. Pranë dëgjoja frymëmarrjen e xhaxhait. Vështroja profilin e xhaxhait, ballin e tij të gjerë e me rrudha të thella, të prera si me thikë. Diçka mendonte. Ndoshta bulevardi i madh i kujtonte atij parakalimin e parë... I shoqëroi me sy fëmijët e kopshtit derisa ata u kthyen diku matanë ministrive dhe buzëqeshi. Nuk e kuptova pér se. Atë kohë më lindi një mendim i ri në kokë, ndoshta fliste mosha ime e re, por mua më lindi një ide në kokë: «A nuk qe xhaxhai ai që i tha babait mbrëmë të më merrte me vete?» Ndaj unë vendosa që të shkoja me xhaxha Vasilin në minierë. Këtë gjë ia thashë dhe xhaxhait. Ai më shtrëngoi fort dorën dhe tha:

— E dija se ti do të më kuptoje drejt dhe më shpejt se yt atë.»

Mbas disa ditësh familja na përçolli deri në stacionin e autobusave. Babai ishte i mallëngjyer. Nëna dhe motrat, ndonëse u vinte keq që po largohesha, dukeshin të lumtura.

Kështu u nisa pra me xhaxhanë, ndonëse, të them të drejtën, më vinte keq që po lija Tiranën.

* * *

— Ndërsa sot kam marrë një vendim tjetër —
më tha duke qeshur. — Dikujt do t'i duket i marrë
ky vendim, por jo. S'është ashtu — dhe sytë i
shkëlqyen më shumë se kurrë. — Vendosa të mbe-
tesha përgjithnjë me xhaxhanë këtu, pranë njerëzve
të punës.

Kishim mbaruar së ngrëni, ndaj u ngritëm dhe
dolëm jashtë. Të dy buzëqeshnim.

P U L E B A R D H A T

Buzëmbrëmje. Nga deti frynte një puhizë e lehtë dhe tej, në horizont, skuqte perëndimi i diellit. Valët përkëdhelnin bregun dhe largohe-shin përsëri pa zhurmë. Dy pulëbardha ndiqnin njëra-tjetrën. Ne ishim ulur në shkëmb dhe sodis-nim detin. Kështu bënim pothuaj çdo mbrëmje. Ule-shim aty dhe rrëmonim kujtimet tona. Kishim ar-dhur në këto anë për të hapur një rezervuar të madh uji. Shumë vjet më parë ne e filluam punën për tharjen e kënetave. Ato na dukeshin të fuqishme, të pamposhtme, uji i amullt i tyre flinte prej shekujsht në atë vend; ne u kundërvumë këtyre ujërave rininë tonë, krahët tanë dhe fituam. Tani, ato vite na du-ken të largëta, por, sa herë që mblidhemi, diçka nga ajo kohë kujtojmë. Ja, dhe sonte Vasili filloi të na tregojë duke buzëqeshur.

«Më kujtohet Saranda, kur bonifikuam Vurgun. Nuk e di, ja, ato pulëbardhat që fluturojnë atje, si-për detit, ato më kujtojnë një ngjarje. Në kantierin tonë kishim një vajzë me flokë të verdhë e me një nishan të zi në anën e majtë të fytyrës. E quanin

Shpresë. Ishte shitëse në klubin e kantierit tonë të ri. Mbrëmjeve, pas punës, edhe pse donim të pinim, edhe pse, të themi të drejtën, na pëlqente ajo buzë-qeshja e saj e émbël, mezi prisnim të shkonim në klub. Kur na vështronte me ata sytë e kaltër plot shkëlqim, ne hutoheshim, skuqeshim dhe shqetësimi ynë sikur përzihej me një farë lumturie. Kur binim pér të fjetur, me zor na mbylleshin sytë, secili prej nesh ëndërronte të ishte i dashuruar prej saj. Shpre-sa nuk ishte e vetmja vajzë në kantierin tonë, aty kishte dhe të tjera, ndoshta edhe më të bukura se ajo, por ajo kishte një diçka të veçantë, sytë e kaltërt dhe atë buzëqeshjen e saj të émbël.

Diçka që ndodhi më vonë më dha një mësim që e kam të vështirë ta harroj. Ishim të rinj atëherë dhe mua më dukej vetja mbi të tjerët. Më dukej vetja më i pashëm, më i ditur, më i guximshëm. Më dukej sikur të gjithë më shikonin, madje edhe ajo, Shpresa. Bota ime e vogël, nuk më linte të vështroja më tej. Nuk isha i aftë të kuptoja se tej botës sime jetonin shokët. Ata ishin të mirë, punëtorë të nderuar dhe me një botë të pastër e të pasur. Ndërsa unë... Eh! Di-ja të punoja vetëm me ekskavator dhe të krekoresha.

Edhe asaj nate, si zakonisht, vajtëm në klub. Me ne kishte ardhur dhe Bilali, saldatori i brigadës. Bi-lali nuk ishte i pashëm, madje hundën e kishte pak si të shtypur. Veçse si punëtor zor t'ia gjeje shokun. Saldonte kaq mirë, sa ne e kishim pagëzuar «artist të brigadës». Unë isha ulur në një pozicion që të bija sa më tepër në sy. Pinim dhe bisedonim. Bufeja ishte e mbushur plot me klientë. Shpresa lante gotat dhe herë pas here na hidhte ndonjë vështrim.

— Një gotë pér «artistin» tonë — thirri Koçoja,

BIBLIOTERA E SH. ZH.

1736 INVENTAR 6475

· një ekskavatorist. — Flori i ka duart qerrata! Ma ka
qepur krahun e ekskavatorit më mirë nga ç'ishte.

Bilali buzqeshi.

— Një gotë për hundën e tij të shtypur — thi-
rra unë, për t'u treguar shakaxhi e qesha me zë të
lartë. Por asnë nuk e pasoi «shakanë» time. Askush
nuk qeshi. E kakarisura ime u dëgjuat në të gjithë sa-
llën. Shokët u vrenjtën. E ndjeva veten ngushtë. Më
dukej sikur nga tavani i klubit rridhët ujë i ftohtë.
Shokët më njihnin dhe e kuptuan «shakanë» time.
E ndjeva veten të fyter dhe u ngrita e dola. Shkova në
fjetore me mendimin që të flija pa ardhur ata, por
gjumi s'më zinte.

S'vonoi shumë dhe ndjeva zërat gazmorë të sho-
këve. Po ktheheshin. Pse kaq shpejt? U shtira sikur
më kishte zënë gjumi. I ndjeva kur hynë brenda. Ata
m'u afroan dhe filluan të më ngisnin. Atëherë u ngri-
ta, sepse ata e kuptuan që s'flija. Fillova të vishesha.
Dasha të dilja nga fjetorja, por ata s'më lanë dhe, de-
sha s'dasha, fillova të dëgjoja sharjet dhe këshillat e
tyre. (Sharjet i mbaj mend më mirë.)

Që prej asaj nate fillova t'i shmangesha shoqë-
risë së tyre. Sa keq është kur njeriu mbetet i veçuar,
por unë atëherë nuk e ndjeja. Më kujtohet një natë.
M'i thanë hapur, miqësisht, ato që ndjenin për mua.
«Ty të është rritur mendja», më tha njëri nga ata.
Ai që po më fliste ishte buldozeristi më i vjetër i
kantierit tonë, ai që më kishte mësuar se si lëvizen
marshet; ishte ustai im, Brahoja. Po unë heshtja,
s'flisja dhe me vete mendoja që ata s'kishin të drej-
të të flisnin kështu, sepse në fund të fundit unë sha-
ka bëra. Kështu mundohesha të justifikoja veten.

Kaluan ditë. Që nga ajo natë nuk kisha vajtur
në klub.

Shpresën e dashuroja. Po tani rrallëherë e shihja, sepse në klub ishin ata. «Nesër mbrëma do ta shoh, mendova, sepse nesër kemi festën tonë, të ndërtuesve.»

Të nesërmen u mblodhëm në klub. Drejtori na falënderoi për punën e mirë dhe në mes të të dalluarve përmendi dhe emrin tim. Ndërsa Bilali u dekorua. Shpresa rrinte në banak. «Mbas mbledhjes do t'ia them të gjitha. Po, po, sonte do t'ia them, për më tepër dhe pas lavdërimit». Mbrëmja mbaroi dhe ne u shpërndamë. Unë po prisja me ankth mbështetur te plepat përballë klubit të dilte Shpresa. Frynte një erë e lehtë. Diçka e panjohur më trokiste thellë në tërë qenien time. Një gjethë u shkëput dhe u përkund te këmbët e mia. Shpresa po rregullonte lokalin. Si mbaroi, u bë gati të dilte. Kësaj radhe do t'ia thosha të gjitha. Mjaft kisha pritur. Tutje, atje nga kallamishtet, dëgjohej zhurma e ekskavatorit që hapte kanalin.

Shpresa doli. I thirra në emër. Ajo e ndali hapin dhe u kthye nga unë pak si e drojtur. Sytë e saj më vështronin me habi.

— Shpresë... prej kohësh... si të thuash, unë...

— Është e kotë. Vasil, unë dua një tjetër — tha ajo duke e kthyer fytyrën nga unë...

Vështrimi i saj ma lidhi gjuhën. Ajo më ktheu shpinën si të deshte të shihte vargun e gjatë të plepave, gjethet e të cilëve përkundeshin si në karusel nga era e mbrëmjes dhe sa vinte po e shpejtonte hapin. Unë ngriva në vend. Nuk isha në gjendje të bëja as një hap përpara. Qesha me vete.

E ndoqa nga pas. Ajo po shpejtonte drejt brigjeve dhe mbas pak u fut në pyllin e dendur plot pisha. Atje do ta kisha më lehtë, atje do t'i shprehja dashu-



rinë me zë të lartë e do t'i thosha se e desha, e desha shumë, si gjënë më të shtrenjtë.

Kur ngjita kodrën, e pashë për një çast të vraponte. Nuk u besova syve! Ç'po ngjiste vallë kësh-tu para meje? Sa bosh u ndodha në ato çaste, kur ajo, aty pranë shkëmbinjve po përqafqohej me atë që unë e kisha tallur aq shpesh për hundën e tij të shtypur, me Bilalin. E njoha, e njoha nga veshja e tij, nga

bluza e kuqe me kuadrate që ai mbante. Po. Ishte ai. Tani kisha vetëm një të drejtë, të sodisja dorën e saj që drejtohej tutje, atje ku deti dhe horizonti kishin marrë një pamje si të ndezur prej flakësh. Në atë ngjyrë aq të bruztë fluturonin dy pulëbardha. Era që vinte nga deti i valavitte flokët e saj. Ula kokën dhe u largova i dëshpëruar. Ecja pa ditur nga po shkoja. Mendime të ndryshme e thumbonin trurin. Padashur vura re se isha futur në mes të kallamishteve, në atë copë kënete që ne po e thanim. Më kishin mbuluar djersët, por unë ecja gjithmonë. E kisha më të lehtë të kthehesha mbrapsht, por një forcë e panjohur më shtynte përpara. Kjo përpara nuk ishte asnjë hap drejt lumturisë së atyre dy njerëzve, por drejt zërave të shokëve. Fjalët e tyre të sinqerta, të fuqishme më grishnin ta shikoja veten si në pasqyrë. Dicëka më buçití në kokë, më duhej patjetër të kthehesha tek ata.

* * *

— ... Kanë kaluar kaq vjet që atëherë — vijoi Vasili. Tani Bilali dhe Shpresa janë në Vanë e Dejës. Dje mora një letër prej tyre. Më thoshin se tani e tutje do të më shkruanin nga Fierza. Më vonë ne u miqësuam dhe u bëmë si vëllezër. Ishim të rinj atëherë. Tani, sa herë që vështroj pulëbardhat, më kujhet kjo ngjarje e largët...

I SHTIRURI

Kur fillova punë, më thanë se do të kisha të bëja me shokun Andon, ose, siç do ta quaj më vonë me përkëdheli, shokun Ndoni. Ky ishte shefi i degës së furnizimit të ndërmarrjes sonë. Për t'u njojur, të nesërmen në mëngjes u futa në zyrën e tij që ndodhej në katin e dytë.

Trokita dhe, kur dëgjova «hyrë», hapa derën. Përballë meje rrinte ulur në karrige pranë një tryeze një burrë i pashëm e shpatullgjerë, rreth të dyzetave, i mbajtur mirë, i rruar dhe i krehur me kujdes.

Si ngriti kokën, më pyeti se çfarë dëshiroja.

I shpjegovala se isha emëruar shofer në degën e furnizimit. Atëhere u ngrit nga karrigia dhe më buzëqeshi me dashamirësi.

«Alamet burri», mendova. Ai më ftoi të ulesha dhe më zgjati kutinë e cigareve.

— Si të quajnë, more djalë? — më pyeti.

— Jorgo — iu përgjigja.

Më erdhi për të qeshur kur më quajti djalë. «Ç'koincidencë, mendova, pikërisht sot që unë kam datëlindjen dhe mbush plot dyzet e pesë vjet.»

— Kështu pra, ne do të punojmë bashkë. Dhe punë kemi plot! — më tha duke ma prishur fillin e mendimeve.

— Puna qoftë, shoku Andon! — iu përgjigja.

Ai u mbështet në shpinëzën e karriges dhe një palë duar të bardha i vuri mbi tryezë. Në këtë takim shoku Ndoni m'u duk njeri i mirë, i sjellshëm. Zyra e tij ishte e madhe dhe e ndriçuar mirë, çdo gjë ishte vendosur në rregull. Nga dritarja dukeshin rruga dhe plepat e zverdhur nga vjeshta. Tej, në horizont, dallohej mali i Dajtit.

Pas pak u ngrita dhe mora të dilja.

— Po shkon? — dëgjova zërin e shefit.

— Si urdhëron, po shkoj në garazh poshtë — iu përgjigja.

— Mirë, more djalë! Sa punë na presin — foli ai si i lodhur.

I dhashë dorën dhe dola jashtë.

Mbas dy ditësh bëmë udhëtimin e parë. U nisëm pér në Elbasan. Rruga ishte mbuluar nga mje-gulla dhe unë ecja ngadalë. Herë pas here i hidhja një sy shoqëruesit. Kishte një profil të rregullt, hundë të drejtë, vetulla të trasha dhe flokë të zes, të dendur. Aty-këtu i shkëlqente ndonjë fije ar gjendi. Por i jepnin më shumë seriozitet syzet, sepse shoku Ndoni, siç më tha vetë, nuk para shihte mi-rë larg.

Heshtjen e prishi i pari shoku Ndoni.

— Ki mendjen, Jorgo! Rruga ka shumë kthesa. More djalë, kemi kaq ditë që jemi njojur dhe, nuk të pyeta një herë pér familjen.

— Kam dy vajza, — i thashë — njérën e kam të martuar.

— Si, more! Vajzë të martuar? — u shti si i habitur. — Pér nder, më kënaqe, more Jorgo! Ti nuk tregon dhe aq i vjetër.

— Jam martuar i ri — i thashë.

— Sa mirë kur i ke fëmijët e rritur, lehtësohesh nga një pjesë e madhe e detyrimeve! Me të vërtetë është kënaqësi... Si thua ti?

— Ashtu është — iu përgjigja pa e kthyer kokën nga ai.

Sa më shumë që i ngjiteshim Qafë Kërrabës, aq më e dendur bëhej mjegulla. M'u desh të ndizja dritat e verdha, të shkurrat.

— Edhe unë kam dy fëmijë, kam edhe babanë plak — e nisi bisedën sérish shoku Ndoni. — Babai më rriti. Nëna më vdiq dhe më la fare të vogël. Unë e nderoj shumë babanë. Kush nuk nderon prindin, ai nuk është njeri. Mbaji mend këto fjalë, more djalë! — e përfundoi fjalën ai. Dukej shumë i mallëngjyer.

Ndërsa ngjitja Qafën e Kërrabës, mendoja: «Sa njeri i dashur dhe i edukuar ky shoku Ndoni!»

Gjatë atyre ditëve kisha vënë re se shokun Ndoni e donin të gjithë në ndërmarrje. Kur vinte në mënghjes, xha Berti, roja, ngrihej në këmbë dhe e nderonte ushtarash, me grushtin lart. Shoku Ndoni i afrohej me buzë në gaz, i jepte një cigare dhe i rrihte shpatullat.

«S'ka si shoku Ndoni!» i dëgjoja shpesh nga goja e njerëzve këto fjalë.



Kishte kaluar një kohë është që nga dita kur fillova punën në atë ndërmarrje dhe unë me Ndonin gemë miqësuar shumë, saqë një ditë më ftoi përvizitë. Pasdite, si u vesha, dola nga shtëpia. Jashtë bin-

te shi. Ishte vjeshtë dhe mbrëmja kishte derdhur ngjyrën e saj të murrme.

Tani kisha plot një orë që isha njohur me familjen e shokut Ndoni. Ishim ulur rrëth tryezës, me filxhanin e kafesë dhe gotën e konjakut përpara. Radioja transmetonte një pjesë pér violinë, zëri i së cilës sikur e plotëson atë ambient tërheqës e të gjëzuar familjar. Njerëzit, pjesëtarët e familjes së shokut, ishin mjartë përzemërt dhe të dashur. Në një divan ishte mbështetur shoku Ndoni, pak më tej ishin e shoqja, një grua ende e re; dy fëmijët: djali dhe vajza, rrëth dhjetë-dymbëdhjetëvjeçarë, ishin ulur karshi nesh; ndërsa pak më tutje, ishte ulur i ati i shokut Ndoni, një plak i shkuar në moshë, me sy gjysmë të shuar.

— Sokrat! — iu drejtua shoku Ndoni të birit.

— Urdhëro, baba!

— Detyrat e shkollës i kreve?

— Si urdhëron, baba!

— Edhe ti, Enkeleva? — iu drejtua së bijës.

Kur mori edhe nga e bija përgjigje pozitive, shoku Ndoni na tregoi një anekdotë, që ne u shkulëm së qeshuri.

Atë mbrëmje nga biseda mora vesh se shoku Ndoni kishte rregulluar një konflikt familjar, që kishte ndodhur ndërmjet një vjehrre dhe një nuseje, aty në bllokun e tyre. Vetëm plaku qëndronte krejt indiferent në bisedat tona. Ai kishte varur kokën mënjanë dhe dremiste.

Jashtë shiu vazhdonte të binte me rrëmbim. Herë-herë në rrugë uturonte ndonjë makinë. Ne ishim zhytur që të gjithë në atë ngrohtësi që të ngjall në shpirt një farë plogështie.

— Uf, sa i mërzitshëm që është dhe ky shiu! Të mbyll brenda — tha e shoqja, si e pakënaqur.

— Eh, moj grua, nuk ke se ç'i bën, ky është një fenomen i natyrës! — ia priti shoku Ndoni dhe i buzëqeshi së shoqes me dashamirësi.

Atë mbrëmje unë fola fare pak. Kisha dëshirë vetëm të dëgjoja. Shoku Ndoni i dinte të gjitha, pra kisha se ç'të përfitoja.

I hodha një sy orës së dorës, dhe vura re se kisha dy orë që rrija aty. U kërkova leje për të ikur.

— Si kështu? Rrini edhe pak, sa të pushojë shiu — thirri Ndoni, me keqardhje.

— Ju falem nderit, kam mbetur shumë i kënaqur! — u thashë. — Do të vij përsëri.

— Patjetër të na vini — foli e shoqja. — Të na urdhëroni me gjithë gruan.

— Natyrisht, do të vij...

— Pse kaq shpejt? Rrini sonte. Televizori ka një program të pasur — ma ktheu shoku Ndoni.

Unë u pëershëndeta me ta dhe zbrita shkallët.

Kjo ishte njohja e parë me familjen e shokut Ndoni.

*

* * *

Një mbrëmje po shëtisja i vetëm në Rrugën e Barrikadave. Ajo rrugë më ka pëlqyer që në rini. Vitrinat e dyqaneve shkëlqenin. Shëtisja i vetëm me mendimet e mia. Trotuarët ishin plot njerëz; veshi më zinte copa bisedash të shkëputura, të qeshura. Aty pranë një fëmijë qante. E éma jepte e merrte me të. Përpara një sporteli shiteshin biletat për ndeshjen e nesërme të futbollit. Rosticeritë dhe lokalet

e tjera ishin mbushur plot me klientë të zhurmshëm. Jeta në këtë copë rruge rridhte e gjallë si një lumë i rrëmbyer.

Unë ecja pa u nxituar si njeri i ngeshëm. Në atë çast s'di pse m'u kujtua shoku Ndoni.

«Do të jetë në shtëpi, thashë me vete. Me siguri po. Ai s'para del në ditë javë, vetëm të shtunave e të dielave e sheh në shëtitje.»

Kisha filluar ta doja atë njeri, jo pse ishte eprori im, por thjesht si shok.

U nisa me mendimin se atje do të kaloja disa orë në një shoqëri të këndshme.

Shoku Ndoni banonte në një nga pallatet e shumta, në rrugën «Muhamet Gjollesha». Pas disa minutave, si ngjita shkallët, u ndodha përpara derës së apartamentit të tij. Vura gishtin tregues te zilja, por diçka si grindje, si zhurmë që vinte nga apartamenti i tij, më stepi.

Matanë derës dëgjoja zëra, të qeshura tallëse fëmijësh, ndërsa një zë burri, që thërriste tepër nervoz. Fjalët arrinin të shkëputura deri tek unë.

— Pensionin... Ti e ke fsh... Ah, derdimen! —
(Zëri i burrit.)

— E kam... dale... të qetë... nipçe... (Ishte zëri i dredhur i plakut.)

Një zë gruaje:

— Matuf... ti... çfarë...

— Ha, ha, ha — uuuu! — qeshte më gjithë shpirt një zë fëmije. «Me siguri Sokrati,» mendova unë.

Pastaj një grumbull fjalësh të ngatërruara. E mbi të gjithë ngrihej zëri solo i shokut Ndoni. Veshi më kapi një fjali të plotë.

— E di që të mbaj me bukë?

Një valë e nxehjtë zemërimi më përshkoi. Ki-



sha përgjuar në derën e botës, sa gjë e urryer, por unë ja që aty u ndodha fare rastësisht.

Shoku Ndoni, idhulli im, ai që i lëshonte aq bujarisht buzëqeshjet, ai që çdo mëngjes i rrithë shpatullat dhe i jepte cigare xha Bertit, rojes, Ndoni, që pak ditë më parë, aty në lagje kishte rregulluar një konflikt familjar...

Trokita. Zérat u shuan. Derën ma hapi vajza.

Dy fytyra tē vrenjtura u çelën menjëherë.

— Oho! Jorgoja! — thirri Ndoni. — Hyr bren-
da... Ku humbe, more djalë?

Hodha sytë nga kuzhina. Në njërin cep tē minderit, rrinte kokulur plaku, duart i kishte tē mbësh-tetura mbi gjunjë. Ishte krejt i shkopsitur, flokët e bardhë i kishte tē shpupurisur, i ngjante një zogu tē vetmuar që e kanë sulmuar skifterët. Në faqet e tij tē rrreshkura pashë lot.

Bëra tē kthehesha nga kisha ardhur, por Ndoni e kuptoi se unë tashmë çdo gjë e kisha marrë vesh, ndaj dhe tha:

— Pa ulu pak tē bëjmë një çikë muhabet se, ç'është e vërteta, u mërzita pak tanë. Plasa së edu-kuari fémijët, mirëpo do ti, ata prapëseprapë na mërzitin. Zihen me njëri-tjetrin. Më vjen keq për babanë, se pleqëri hesapi e s'duron dot shamatë. Ele-ni, tē lutem na bëj nga një kafe — i foli ai së shoqes duke u munduar tē buzëqeshte.

— Ju falemi nderit, më duhet tē shkoj... kam një punë tē ngutshme... — bëlbëzova shpejt. — Erdha...

— Të lutem, mos na e prish — foli me mirësjell-je e shoqja e Ndonit.

— Erdha vetëm tē lajmëroja se makinën e kam gati për nesër, për në Korçë.

— Mirë, o, po rri de sa për një kafe — nguli kë-mbë shoku Ndoni.

— Ju falemi nderit, më presin... kam punë.

Ai u afrua... Vështrimi i tij ishte i papërqën-druar. Bebëzat e syrit i dridheshin dhe cipëza e lëku-rës së fytyrës i mori një ngjyrë tē mavjosur. Donte tē fliste, tē thoshte diçka, po s'kishte forcë.

— Si kështu, pa një kafe? Kaq shpejt! — U mundua të buzëqeshte...

Unë heshta, por vështrimin nuk ia ndava.

— Ti... ti... sikur...

Ai nuk ishte në gjendje të vazhdonte bisedën.
I ktheva kurrizin dhe u largova.

Teksa zbrisja shkallët, më ranë ndër mend fjalët e shokut Ndoni:

«Kush nuk nderon prindërit, nuk është njeri!»
Nesër, kur të jemi të dy, do t'i them se unë i dëgjova të gjitha. Pastaj, do ta bëj problem të organizatës.

THJESHTËSI

Na thanë se kishte ardhur drejtori i ri i kantierit tonë. Ishte kohë dreke dhe ne ishim në mensë. Ai ishte veshur me një palë rroba doku, qëndronte përpara nesh me duar prapa dhe si i menduar. Ai njeri nuk kishte asgjë të veçantë, fytyrë të bronctë, sy ngjyrë plumbi dhe flokë të dendur thinjoshë.

Drejtori i vjetër na e paraqiti dhe i uroi atij punë të mbarë. I riu buzëqeshi me drojtje dhe tha disa fjalë falënderimi. Pastaj ne u shpërndamë me përshtypjen se drejtori i ri ishte njeri i ftohtë dhe kjo përshtypja nuk na u nda nga mendja për ditë me radhë.

Çdo pasdite, kur kthehet nga puna, e gjenim atë më këmbë në sheshin e kantierit. Ne kalonim përpara tij si të zënë ngushtë dhe e përshëndetnim. Vështrimi dhe buzëqeshja na shoqëronin deri në fjetore. Ndonëse ai na buzëqeshte, mua, nuk e di përc'arsye, më dukej njeri i ftohtë.

Në brigadën tonë të gjithë ishim minatorë dhe çdo ditë plagosnim malin e zhveshur e të përhimtë

për të nxjerrë gurë për themeleet e një vepre të mardhe. Dielli i nxehtë i muajve të verës na qëndronte gjithë ditën mbi kokë, djersa përziej me pluhurin e imtë të gurit. Kështu shkonin ditët, me punë e me gëzim. Por ndodhi njëherë që ai copë mal i përhimtë të mos u bindej më krahëve tanë. Pistoletat na dri-dheshin në duar; provuam mënyra të ndryshme, por suksesi ishte i paktë. Ktheheshim në kantier të lodhur e të mërzitur, e pse jo dhe të turpëruar. Na dukej sikur i gjithë kantieri na shikonte vetëm ne, brigadën e minatorëve.

— Djem të fortë! Minatorë të vjetër! — qeshi me ironi Aleksi, brigadieri ynë, duke përmendur fjalët që thuheshin dikur për ne, një pasdite kur po ktheheshim nga puna.

— E po ç'të bëjmë? — thashë unë. — Ne ata që qemë jemi.

— E atëherë të ngremë duart! Kështu të bëjmë? — u kthyte Aleksi nga unë dhe ngriti duart. Fytyra e tij e gjerë dukej e zemëruar. — Dale, Aleks, mos u zemëro! — ia ktheu atij drejtori. Atë natë drejtori po kthehej me ne për në fjetore. Sot tërë ditën s'na është ndarë. Dhe ai është shumë i shqetësuar.

Ne u turpëruam dhe njëkohësisht u inatosëm me Aleksin që e hapi këtë bisedë në sy të drejtorit. Vazhduam të ecnim. — Unë e kuptoj drejt zemërimin e Aleksit — vazhdoi drejtori. — Shokë, nga duart tuaj pret i gjithë kantieri.

Ne të gjithë nuk folëm. Fjalët e tij ishin të drejta. Shqetësimi ishte i përbashkët.

— E di që keni rënë në një shtresë të re e të fortë. Nesër të shohim se mos na ndihmojnë barominat.

Kishim arritur te fjetoret. — Tani çlodhuni. Nesër na pret një punë e vështirë — tha Aleksi.

— Minatorët janë djem të fortë! — e mbylli bisedën drejtori.

Unë ula kokën; kjo lëvdatë më dukej si e tepërt, pikërisht sot. Ne nuk ndjeheshim të qetë. Shokët hynë në fjetore, ndërsa unë nuk hyra fare dhe po shëtisja i vetëm. Mendoja për punën dhe shokët. Ishte e para herë që na ndodhët kështu. Gjithmonë kishim pasur rezultate të mira në punë. Sillja ndër mend fytyrat e shokëve të rrahura nga era dhe dielli, sytë e tyre të gjallë e plot dritë. Ndodhë që të ishin të rreptë... Kështu mendoja tek shëtisja në she-shin e kantierit. Mbi kupën e qiellit ndriste hëna dhe vezullonin yjet. Poshtë në thelli të luginës gjithçka dukej e heshtur. Lumi i vogël malor shkiste me shushurimë mbi shtratin e tij. Nga malet frynte një erë e lehtë dhe e freskët. Ndërsa pylli përreth dukej sikur murmuriste. «Nesër, nesër patjetër do t'ia dalim mbanë.» Hyra në fjetore. Dhe atje po ziente biseda. «Nesër do t'ia dalim mbanë.»

* * *

Të nesërmen u ngritëm shumë herët. Yjet ende nuk qenë shuar. Ecnim nëpër rrugën e ngushtë të malit Ecnim njëri pas tjetrit si një skuadër ushtarësh. Mbas një copë rruge u gjendëm në gurore.

Mali i përhimtë dukej edhe më i zymtë. Ai na përfshi, të gjithë nën hijen e tij të madhe.

— Mirëmëngjes!

Të habitur u kthyem nga zëri. Ai që na kishte folur ishte drejtori i ri.

— Si e keni punën, djem? Si shumë herët jeni ngritur! — na tha.

— E po, puna e mirë bëhet herët!

— Ashtu? Mirë, djem! I tha këto fjalë dhe hyri në barrakën ku mbanim veglat e punës. Ndezi dritën dhe nga grumbulli i hekurishtave mori një barominë. Ne i shkelëm syrin njëri-tjetrit.

— Këtij i vjen era punë — tha Qemali me zë të ulët.

Agimi i ditës na gjeti të shpërndarë nëpër faqet e malit. Poshtë, në rrugën e madhe, lëviznin kamionët... Drejtori qëllonte me përpikmëri mbi kokën e barominës. Dy krahë të fortë si dy leva uleshin e ngriheshin vazhdimi.

Ne, të shpërndarë nëpër faqet e malit, filluam të qeshnim. Vinim re dhe buzëqeshnim nga kënaqësia tek shihnim drejtorin që i qe përveshur punës. E pashë mirë kur ai me Aleksin fshiu me pëllëmbë ballin e djersitur.

Dielli filloj të digje e ne i hoqëm këmishët. Pushtimin e drekës e bëmë nën hijen e barrakës. U ulëm në formë rrëthi dhe nxorëm për të ngrënë.

— Unë s'kam marrë gjë me vete — tha drejtori dhe buzëqeshi.

— Urdhëroni të hamë! — ia pritëm me një zë dhe i bashkuam ushqimet tonë.

— U lodhët, djem? — na tha ai duke u përtypur.

— Si të thuash, shoku drejtor — iu përgjigja unë. — Kur puna ka rezultat, lodhja të largohet. — Unë s'ia ndaja sytë.

Duke parë atë njeri, mendoja për thjeshtësinë dhe më vinte inat që patëm atë mendim në fillim për të.

— Çohuni, djem! Erdhi koha për të shpërthyer minat — thirri Aleksi.

Lugina gjëmoi. Nga trupi i malit u shkëputën copa të mëdha shkëmbinjsh...

Mbas punës morëm rrugën për në kantier. Ishim të djersitur e tërë pluhur. Ajo mbrëmje na u duk më ndryshe nga të tjerat. Shpirti ynë qeshte, gëzimi i punës së kryer na kishte pushtuar të gjithë.

Ruga malore ishte e ngushtë. Ecnim në njëshkonë. Në krye ishte Aleksi, ndërsa në mes nesh, i qeshur e fjalëpak, ecte drejtori i ri i kantierit tonë...

VIOLINA E HESHTUR

Pas Koncertit unë dhe miku im R. u ulëm në një bar-bufe. Ende nuk na ishin larguar mbresat që na la shfaqja. Përpara se të hynim në sallën e koncerteve, ai ishte i gëzuar, ndërsa tani fytyra e tij dukej mjaft e tronditur.

Ka raste kur njerëzinë e sëmbon një kujtim i largët. Kështu ndodhi dhe me mikun tim. Vura re se atë e mundonte diçka më shumë se emocioni. Ai rrinte para meje i tretur thellë në mendime.

— Eh, more Nush, sa vite kaluan! — pëshpëriti ai si me vete.

— Nuk ju kuptoju ku e keni fjalën — thashë i habitur.

Miku im buzëqeshi.

— Ai djaloshi, solisti me violinë, ai që e putha pas shfaqjes, është djali i një shokut tim. A e vure re se çfarë duartrokëtjesh! — thirri duke harruar se në lokal kishte edhe njerëz të tjerë, që e vështruan të habitur.

Gishtërinjtë e tij të hollë e delikatë prekën lehtë mbi dorën time. Në atë fytyrë të plakur unë ndjeva

gëzimin dhe mallëngjimin. Mikun tim e ngacmonte diçka përbrenda, e vrullshme e ai ndjente nevojë të domosdoshme për t'u çliruar, ndoshta nga një ankth që e mundonte prej kohësh e që i mori udhë nga shfaqja e porsaparë.

— Dëgjo — më tha. — Ndoshta ty nuk të hyn në punë jeta jonë e kaluar, prej muzikanti, dhe...

— Më vjen keq — iu përgjigja, duke i ngulur sytë në vështrimin e syve të tij të mëdhenj që kishin mbetur ende të bukur. Ata sy ishin pak të lagur e të mjegulluar.

«— Me Nushin ishim shokë. Që të dy ishim muzikantë. Ai i binte violinës dhe unë klarinetës. Trupin e kishte të brishtë, aq të brishtë, sa dukej se do të thyhej qoftë edhe nën goditjen më të vogël. Puttonim bashkë në pijetoren «Bibili», në atë karakatinë të vjetër që ngrihej diku, në cakun më të largët të qytetit. Çdo natë jeta në një farë mënyre hidhte rrëth vetes një valle të çmendur. Njerëzit shtyhesin, shanin njëri-tjetrin dhe mundoheshin të fitonin buzëqeshjen e kërcimtares, që zbardhë dhëmbët dhe hidhej si e harbuar.

Kjo mënyrë jetese mbaronte afër mëngjesit, kur zbrazeshin portofolet dhe pastaj gjithçka qetësohej e binte në një gjumë të thellë, kur i zoti i kabaresë mbyllte derën dhe fillonte pastrimin. Kështu, mëngjeseve, ne ktheheshim në shtëpi të kapitur fizikisht dhe të dërmuar shpirtërisht...»

Shoku e ktheu gotën që kishte përpara dhe vazhdoi:

«... Atëherë çdo gjë shitej. Shitej shpirti, shitej nderi, edhe muzika shitej. Një natë në kabare erdhë një zotni. Ishte i veshur mirë, kishte një kokë krejt të bardhë, dy sy të përgjakur e të dalë nga zgat

vrat dhe një hundë të kuqe. Pronari i bëri vend aty pranë banakut atij njeriu që e shihnim për herë të parë.

Unë dhe Nushi rrnim të heshtur në të ndarën tonë. Zotnia e hodhi vështrimin nga ne dhe diç i tha pronarit, në vesh, duket diçka të bukur, sepse ky i fundit qeshi, duke zbuluar një palë dhëmbë prej floriri. Nushi rrinte i qetë me violinën në prehër. Fyttyrën e kishte të zbetë dhe dukej mjaft i trishtuar. Prej ditësh e kisha vënë re se ai nuk qe mirë.

— Më merret fryma, — më tha — a dalim pak jashtë?

Dhe ne dolëm.

Ishte muaji nëntor. Qielli ishte i pastër dhe hë-na ndriçonte zbetë. Rrugët e murrme me kalldrëm ishin të shkreta. Hijet e plepave të kallnin një farë frike. Rrinim të dy pa folur. Ishim të lodhur. Pamë që u hap dera e pijetores dhe prej andej doli prona-ri. Hija e tij dukej e zbetë.

— Hajdeni, djem! — foli ai me zërin e tij të gér-vishur.

Ne e ndoqëm nga pas.

Kur hymë brenda, turma gjysmë e dehur na pri- ti me potere. Ata ishin të zemëruar me ne. Ne s'duhej të çlodheshim.

Një natë tjetër, ndërsa po çlodheshim, zotnia i thirri Nushit. Ai iu afroa pranë dhe e përshëndeti me kokë...»

R. e ndërpreu tregimin e tij. Salla e bar-bufesë tashmë thua jse ishte boshatisur. Ishte ora 10. Shikimi i mikut tim shprehte keqardhje.

Ajo bisedë na kishte rrëmbyer të dy. Kamerier- ja sillej me padurim me fshesë në dorë. Miku im ish-

te mbërthyer keqas nga kujtimet, po dhe unë u bëra kureshtar.

— Pastaj, çfarë ndodhi? — pyeta.

Ai ngriti kokën si të zgjohej nga ndonjë ëndërr.

«... Ah, po... Ku e lamë? Po, po, tamam aty...

Zotnia qeshi dhe, kur Nushi, qe afruar i tha:

— Nush, ma merr një herë atë këngën e «Garpit». Apo s'e qani ju, jevgjit, atë këngë. Sa për pare, mos ki hall... do të të paguaj mirë.

Vura re se Nushi u trondit, buzët filluan t'i dri-dheshin dhe fytyra iu skuq. Buzëqeshi hidhur. Nushi i ngjante shumë violinës. Tek ai çdo ndjenjë shpër-thente e hollë, delikate dhe gati e paprekshme. Ishte shpirti i artistit që buzëqeshte aq hidhur. Pronari iu afroa, iu përul zotnisë, vuri dorën mbi supin e Nushit dhe i tha:

— Fillo, Nush, zotnia deshi të bënte shaka.

Nushi ia hoqi dorën me forcë dhe u kthyte menjëherë.

— Të poshtër!

Kaq tha dhe iu drejtua derës.

Dolëm së bashku. Më kot u mundua pronari të na e mbushte mendjen për t'u kthyer. Ecëm të hesh-tur deri aty ku sot ngrihet Pallati i Madh i Kulturës. Kishte kaluar mesnata, qendra e qytetit ishte e pajetë dhe e ftohtë. Nata ishte kredhur në një zbrazë-tirë të pafund.

Nushi ecte dhe kollitej. Filloi të dridhej nën kostumin e tij të hollë. Unë hoqa pallton e madhe dhe ia dhashë, ia hodha krahëve. Edhe sot nuk e kuptoj se pse e doja aq tepër atë njeri, shqetësohesha për të, si për një fëmijë. Prej kohe ishte i sëmurë. Dhe kjo ndodhë, nga që ne punonim shumë dhe hanim pak. Trupi i tij i brishtën nuk mundi të duronte. Punonte

ai, se fëmijët donin bukë Mbahëj me zor. E ndjente veten të sëmurë, por ilaçet ishin të shtrenjta. Dhe çdo ditë fytyra i zbehej dhe sytë i zmadhoheshin, megjithatë ai e mbante veten me zor. Duhej të ushqente fëmijët. «Durim, vëlla, më thoshte. Durim, se kemi fëmijë.» Dhe atëherë unë vështroja se si faqet, që kishin filluar t'i rreshkeshin, i lageshin nga lotët... Po që prej asaj nate nuk u ngrit më nga shtrati. S'thonë kot që zemërimi e bren njerinë.

Një pasdite, ndërsa rrija pranë tij, ai u ngrit ndejnur dhe më kërkoi violinën, jo me zë, por duke drejtuar gishtin nga ana e raftit.



— Ti je i sëmurë — kundërshtova unë... dhe diçka e shpejtë e zotëroi tërë mendimin tim...

Ai tundi kokën, si të desh të kundërshtonte lutjen time dhe sytë e tij sikur më thoshin: «Sillma, se dua të ekzekutoj diçka!»

Eh, në atë qetësi të heshtur, veç të dëgjoje... Tingujt të kujtonin pranverën, ata ishin të lehtë si krahët e fluturave, si fëshfëritja e gjetheve, si shushurima e lumi. Ata tinguj tashmë fluturonin të lirë si flladi në pranverë.

Nushi ishte rrëmbyer i téri pas atyre tingujve që i buronin nga thellësia e shpirtit. Ai nuk ishte më në mes të atyre fytyrave të shtazëruara që tërboheshin pas vallëtares, që derdhnin para dhe pastaj bërtisnin si buaj të therur në llum. Ai tani fliste lirisht me ndjenjat e tij, gishtërinjtë e dobët preknin lehtë mbi tela. Atë pak kohë ai dukej se ishte i lumtur, shumë i lumtur...»

Miku im R. vazhdoi:

«E dëgjoja si i magjepsur e jo vetëm unë. Pa undier, dhoma ishte mbushur plot me njerëz, komshinj, njerëz të varfér si edhe vetë ai. E shoqja kish te qëndruar më këmbë te dera dhe herë pas here fshinte sytë. Ky si të thuash ishte një koncert i vogël. Kur mbaroi, i lëshoi duart si i kapitur dhe psherëtiu me një ofshamë të zgjatur. Të them të vërtetën, atë kohë kalova shumë ditë të dëshpëruara. Rrija pranë shokut tim dhe shikoja se si tretej ai çdo ditë.

Në ditën e fundit të jetës, Nushi thirri të shogën. Dhoma më dukej e zyrtë, drita e venitur e lumbës ia tregonë fytyrën edhe më të zbetë. Më bëri shenjë dhe mua të afrohesha. Sytë e tij të zmadhuar tregonin dhembje. Nushi i foli së shoqes:

— Të kam dashur, Marie. Gjithnjë të kam da-

shur, ashtu siç e desha dhe muzikën. — Zëri i dilte i mekur dhe i dobët. — Do të të lutem për një porosi. Asnjë nga fëmijët tanë të mos bëhet muzikant, më dëgjove? Ndryshe i pret pijetorja «Bilbili». Violinën shite — kaq tha dhe heshti.

Ndaj të gdhirë ai mbylli sytë. Maria nuk e shiti violinën, e mbështolli me kujdes dhe e futi në arkën e saj, aty ku mbante gjérat më të shtrenjta të jetës... Dhe ja tashti, i biri...»

Këtu shoku im R. heshti.

Disa të rinj që po kalonin tutje trotuarit zunë të qeshnin. Muzikanti plak i vështroi me zili dhe u hodhi një vështrim dashamirës. Me këtë njeri isha mi-qësuar nëpërmjet fëmijëve, nipërit e tij dhe fëmijët e mi mësonin së bashku në shkollën e muzikës. Nuk kishte gjësim më të madh për të sesa kur ata mbaronin mësimin dhe ai mes tyre kthehej në shtëpi.

— Mos u lodhe? — më pyeti. — Kështu e kemi ne, pleqtë, — tha — rrëmojmë nëpër hekurishte dhe gjejmë aty diçka dhe fillojmë t'i mërzisim të tjerët me kujtimet tona.

— Të lutem — thashë unë. — Më kënaqi shumë tregimi yt.

KUJTIME FËMIJËRIE

Mësuesi

I shtë gjithnjë i qeshur e i dashur, ndonëse vinte shëndetlig e kolla e ngacmonte shumë. Nganjëherë e zinte në mes të mësimit. Kollitej aq shumë, sa i skuqej ftyra dhe balli i gjerë i mbushej me djersë. E donim shumë mësuesin tonë dhe ai na donte shumë sidomos ne, këmbëzbathurit.

Shkolla jenë ishte një ndërtesë e vjetër prej qeripiçi, me suva të rënë dhe me dritat e mbrojtura nga hekura në formë katrori. Përpara shtrihej një shesh i madh krejt i thatë e tërë gropë. Ky ishte oborri i shkollës. I vetmi zbulurim i tij ishte një man i madh, të cilit nuk ia linim kokrrat të piqeshin.

Një ditë mësuesi hyri në klasë shumë i mërzitur. Kurrë nuk e kishim parë aq të vrenjtur. Atë ditë mësuesi për herë të parë e prishi zakonin e përhershëm. Filloi të shpjegonte pa bërë apelin. Dhe shpjegimi ishte i thatë, thuajse mësuesi përtonte të fliste. Atë ditë ai nuk e kishte gjallérinë e zakonshme që të bënte për vete. Dukej i lodhur. Në klasë bënte vapë. Filluam të shqetësoheshim. «Ç'të kish te vallë mësuesi, ç'e shqetësonte atë». Pikëllimi i tij

na pikëllooi dhe ne. Ra zilja. Ne krejt instiktivisht u ngritëm më këmbë. Por ai nuk doli nga klasa. Mbetëm si të ngrirë. Mësuesi, si shëtiti pak nëpërmjet rreshtave të bankave, me zërin e tij të qetë na tha neve, katër-pesë vetave, të dilnin përjashta. Ne u stëpëm edhe më shumë. Megjithatë iu bindëm. Në korrider, duke u munduar të buzëqeshte, na tha se na priste në shtëpi pasdreke.

Dolëm nga shkolla të heshtur. Ajo ditë na u duk e gjatë. Dhe vrismi mendjen të gjenim arsyen përsë na kishte thirrur mësuesi. Mos kishim bërë ndonjë prapësi? Por jo. Ne e donim mësuesin dhe mundo-heshim të mos e mërzitnim. Mos janë ankuar plakat e mëhallës. Se, ç'ishte e vërteta, në shtëpi a në mëhallë bënëm ndonjë prapësi.

Pasdite vajtëm në shtëpinë e mësuesit, ky na futi në dhomën e tij dhe na gostiti të gjithë me sheqerka. Ne prisnim gojëhapur se ç'do të na thoshte.

— Djem! — foli ai mbas pak. — Fashistët kanë vrarë mikun më të mirë të fëmijëve.

— Kush është ai, zoti mësues? — pyetëm ne, të gjithë, me një zë.

— Qemal Stafa — u përgjigj mësuesi. E, si e mbledhi veten, tha i vendosur:


— Fëmijë! Sot do të mësojmë një këngë të re, e kjo këngë nuk është as për fluturat e as për pranverën. Por për mikun tonë të shtrenjtë.

Të mbledhur kokë më kokë, si ata zogjtë ende të parritur, ne filluam të mësonim këngën e re. Emri i Qemalit dilte nga buzët tona të zjarrrta, ashtu si zëri ynë i njomë. Filluam ta këndonim me zë të ulët. Mësuesi filloi të çelej në fytyrë. S'kaloi shumë kohë dhe kënga mori dhenë dhe e mësuan të gjithë fëmijët e lagjes. Kjo këngë sikur na zgjoi nga gju-

mi, na ngrohu zemrat. Dhe kënga për heroin komunist na lëvrinte nëpër deje, së bashku me gjakun.

Kënga

Një ditë, ashtu siç ishim, grumbull, vendosëm të shkonim në fushën e lojërave dhe të luanim. Me vete morëm edhe topin e futbollit. Dolëm andej nga Tirana e Re, dhe me britma e rrëmuajë kaluam andej nga vilat e italianëve. Kur mbërritëm në fushë, vumë re fëmijët me fanella të bardha. «Prapë na e pas-



kan zënë fushën «balilat e fëlliçur», tha njëri prej nesh. E dinim që quheshin «balila», po, se çfarë kuptimi kishte ky emër, s'e dinim.

Iu afroam fushës. Ata e kthyen kokën nga ne, pak si të trembur, sepse jo rrallëherë ne, rrugaçët, siç na kishin pagëzuar prindërit e tyre, i kishim nxjerë me forcë nga fusha këta bandillë të majmë si derrkucët. Ne donim fushën. Ajo na përkiste neve. Ata s'kishin asnjë të drejtë mbi të dhe ne duhej t'ua merrnim me çdo kusht.

Njëri nga ne iu afroa grupit të tyre.

— Mbushuni që këtej! — u thirri shqip.

Por ata, si për çudi dhe për inat tonin, filluan të këndonin hymnin e tyre.

U mblodhëm për të menduar se si do t'ia bënim.

— T'i rrëhim, t'ua bëjmë turinjtë pëershesh — tha Petriti, boksieri i grupit tonë tepër i nxehur.

— Të këndojmë dhe ne — thashë unë — këngën që na mësoi mësuesi.

Filluam të këndonim ashtu siç dinim. Melodia e këngës herë ngrihej e herë ulej, si dallgët e tërbuara të detit. Qe një përlleshje zërash, ndjenjash, një lutfë se kush do ta mundte tjetrit.

Zërat po na ngjireshin dhe ne nuk pushuam, përderisa kënga e faßhistëve, e balilave, filloj të mëkej e pastaj u shua fare.

Ata ikën kokulur. Duket i zuri frika.

Fusha na mbeti neve, por nuk na luhej më.

Dielli tashmë po perëndonte, disku i tij i zjarrtë qe fshehur përgjysmë prapa kodrave të qytetit. Nxit-tuam për të qënë sa më parë në shtëpi. Na dukej sikur po ktheheshim nga një betejë, ecnim në rregull njëri pas tjetrit, dhe jo ashtu, me rrëmujë, si zakonisht.

«V. F. L. P.»

I shte e pesta natë që ndesheshin vështrimet e tyre. Pas tryezës së madhe ishte ulur një shkurtabiq me fytyrë të zbetë dhe me sy të blertë. Ky ishte hetuesi. Qafa e hollë si e një zvarraniku lëvizte lirisht brenda jakës së gëzoftë të uniformës. Ndërsa përballë tij më këmbë qëndronte tjetri i lidhur me hekura. Nga këmisha e çjerrë i dukej gjoksi i madh leshtar tërë shenja gjaku. Nata dukej e qetë. Jashtë dëgjohej ece jaku i rojes. Llamba lëshonte një dritë të mekur, sahati i vjetër në mur shënonte orën 23. Zyra ishte e vogël dhe e zyrtë, ajri i ndenjur të merrte frymën. Ata kishin dy orë që qëndronin përballë njëri-tjetrit.

— T'i japim fund — folën sytë e blertë. — Mjaft! Që të dy jemi të lodhur. Do të t'i heqin hekurat. Pastaj do të ulesh pranë tryezës. Do të ulesh si zotëri dhe do të hash sa të ngopesh. Hë, si thua? — lëviznin pa ndërprerje sytë e blertë. — Do të kesh para, liri, gra, ti je goxha djalë. Je dhe i pashëm! Pa vështromë mua! Paguhem mirë, jam veshur e jam ngjeshur... Mirë, si të duash... Nuk do?... Paç veten në qafë, pra! Unë po të dal nga borxhi.

Zëri i hetuesit dilte si i përvajshëm e gati-gati lutës.

— Ke pesë ditë, more! Pa shihe veten si je katandisur... Ç'do të thotë jot émë? Ta dish, ndryshe do të flasë përsëri kamxhiku. Tanimë ti e njeh kapterin tim; ka dorë të rëndë ai, që djalli ta marrë!

Tjetri kishte puthitur buzët e buhavitura e të zhuritura nga etja dhe as që kishte ndër mend të fliste.

— Ncë, ncë, ncë! — filluan sytë e blertë. — Hm! . Ç'kokë! Në fund të fundit kë mbron ti, more? Çfarë mbron? Hm...

Pas kësaj oratorie të përsosur uniforma e zezë u ngrit nga karrigia, vuri duart pas kurrizit dhe filloj të ecte nëpër dhomë. Ishte bërë nervoz e kjo dukej fare mirë nga gishterinjtë me damarë mavi që i shtrëngoi sa i kërciten kycet. Iu afrua dritates dhe i hodhi sytë jashtë. Ajo kokë e vogël diç i bluante... Jashtë qielli, ndonëse qe dimër, ishte i kthjellët dhe i pastër, hëna ishte e plotë, por bënte ftohtë. Në dhomë rëndonte heshtja plumb. Një mendim i tmerrshëm e bëri të dridhej uniformën. E ndjeu se kishte frikë. Po sikur... sikur ky njeri i lidhur t'i japë një grusht në kafkë e ajo të çahet më dysh? «Bobo, sa i paska duart! Duken që janë duar kovaçi, të mëdha, të nxira e të rënda çekan». Nuk duhej të qëndronte pranë tij. Zuri të fliste me vete: «Ncë, ncë, ncë, nuk duhet të rri aq pranë tij.» Ndjeu sikur gjunjët e dobët iu blokuan. U mundua të tregohej gjakftohtë, kështu ia donte zanati. Kishte dhënë fjalën. Do ta zbuste. Do ta bënte që ta ndiqte nga pas si një manare. Ishte betuar me fjalën e nderit të oficerit (nderi fashist!). Pa ç'ka se më vonë shefat e tij e dinin vetë... E pra,


ishte e pesta natë që po ndesheshin. Pesë ditë e pesë net me radhë që kamxhiku nuk ishte çlodhur asnjë çast. Po, pér gudi, njeriu i lidhur heshtte. Sa ta nënshtronte, do të shkonte te shefat e tij dhe do t'u thoshte duke u mburrur:

— Zotërinj, e pérula, e nënshitrova!

— Bravo, Janaq! — do t'i thoshin. — Je djalli vetë, pér onder!

«E vërtet ashtu jam, djalli vetë, s'e kanë keq.» Fytyra iu shtri nga një buzëqeshje e gjerë. Po shpejt u vrenjt. Balli iu tkurr nga një kujtim i hidhur. «Sot janë bërë të gjithë djaj». Një ditë atje, në pijetoren e Stathit, ai hamalli korozi, Guri, i ishte afruar pér të ndezur cigaren dhe ndërkaq i kishte rrahur shpatullat e dobëta me pëllëmbë. Pas pak të gjithë filluan të qeshnin. Shihnin zotin Janaq dhe shkuleshin së qeshuri. Pas kurrizit të tij ishte shkruar me shkumës të bardhë, si mbi një dërrasë të zezë parulla: «V. F. L. P.» E nuk është shaka të qeshësh me një oficer të fashizmit! Dhe kush pa... hamejtë! Xha Stathi kishte ulur kokën aty tek lante gotat dhe kukuriste, sikur gjoja po kollitej. Ajo parullë e «mallékuar» e ndoqi Janaqin nga pas gjer në komandë ku qeshën edhe vetë milicët. Ajo ditë kishte qenë e bukur, me diell dhe njerëzit kishin qejf të qeshnin. Po pse qeshnin xhanëm? Zoti Janaq nuk e dinte si ishte puna, por, kur e mori vesh, u nevrikos shumë. Bërtiti dhe pérpoqi këmbët, shau dhe kërcënoi, madje ndëshkoi rëndë dhe dy nga vartësit e tij. Atëherë e mori vesh ai se edhe e qeshura qenka një formë lufte! Ndaj kishte frikë tani sa herë që e shihte të arrestuarin të vinte buzën në gaz.

E, ndërsa zoti Janaq kishte humbur në të the-



lla, njeriu i lidhur me pranga qëndronte i heshtur, i madh si një shkëmb.

Janaqi ktheu kokën përsëri nga dritarja. Mblo-dhi vetullat dhe u tret në mendime. Jashtë frynte thëllimi i ftohtë. Rrugët e qytetit të vogël ishin të zbrazura e të përgjumura. Ora e murit ra dymbë-dhjetë herë. Mesnatë. Akrepët puthën njëri-tjetrin.

Tjetri mendohej. Sa do të donte të kishte pak zjarr, të ngrohej e të shkrinte gjakun e mardhur... Zjarr!.. Sa zjarre kishte parë ai, zjarre të mëdha që digjeshin dhe ngjiteshin me vërtik drejt qiellit. Dhe këto flakë shoqëroheshn gjithnjë me pushkë dhe këngë. Kurse sonte nata ishte e ftohtë. Po. Nata është gjithnjë e ftohtë... E çfarë nuk fsheh ajo...

«E ke keq punën, i thanë kur e arrestuan, por ai kishte buzëqeshur. E dinte se do ta kishte keq. Dhe këtë e provoi që natën e parë, kur ra në dorë të tyre.

Tani uniforma e zezë kishte zënë të ecte përsëri nepër zyrë. Shëtiste dhe férshëllente një motiv, si duket për të trembur frikën.

— Ncë, ncë, ncë, — murmuriste me vete — ç'kokë!

Iu afrua tryezës, mori shishen dhe mbushi një gotë me raki. Pasi u mendua pak, e vuri në buzë, hoqi nja dy gllënka dhe i kënaqur puliti sytë.

— Ah, safi rrush! — pëshpëriti, por pastaj, si i ra ndër mend se ishte vetëm, fare vetëm me njerinë e lidhur, ndjeu t'i shkonin mornica në trup. Po sikur... një grusht... kafka e çarë... I trembur iu afrua dritäres, hapi kanatin dhe përmes hekurave katrorë i thirri dikujt atje, poshtë:

— Xhafë! O Xhafë! — zëri i dilte i hollë, i thatë, i zbetë. — Xhafë!..

— Urdhéro, zoti toger! — u dëgjua nga jashtë zéri i atij që quhej Xhafë.

— Lér dikë tjeter atje dhe ngjitu këtu lart.

— Si urdhéron, zoti toger!

Pas pak shkallët e drunjta të ndërtesës kërcitën nën peshën e hapave të nxituar. Dera e zyrës u hap me forcë dhe në prag të saj mori qëndrim «gatitu» kapter Xhafa, që i veshur me atë uniformë e zezë, i ngjante një qeni bulldog. I buzëqeshi në mënyrë konfidenciale eprorit dhe goja e madhe zbuloi në vend të dhëmbëve një palë çatalle.

Gjarpri mori një gotë dhe, si e mbushi, ia dha bulldogut.

— Merre, Xhafë, sonte është ftohtë, le të nxehemi pak!

— Hi-hi-hi! — qeshi Xhafa dhe e rrëkelleu në thellësi të zverkut të trashë atë gotë me raki.

— Të falem nderit, zoti toger, shumë të falem nderit, qenka me të vërtetë safi rrush! — dhe vazhdonte të qëndronte gatitu, si një hu.

Për disa minuta sytë e etur për gjak të bulldogut shëtitën mbi mishrat e mavjosura të njeriut të lidhur. Pastaj u ngjitën mbi fytyrën e tij, ku u ndalën gjatë. Kërkonin një copë vend të pacënuar dhe u duk se u habitën, kur e vunë re një gjë të tillë. «Nëse do më lërë ta rrah përsëri, mendoi, do t'ia prish atë fytyrë të pacënuar, atë shprehje krenarie, ah, të më lënë!»

Orët përcillnin njëra-tjetërën e ata flisnin e qeshnin, pinin e këndonin si dy njerëz të ngeshëm, ndërsa ai... ai qëndronte më këmbë. Të qëndruarit aq gjatë më këmbë ishte një torturë, e lodhshme dhe nata... jo, ajo s'kishte të sosur. Kurse ata pinin dhe prisnin që shkëmbi të lëkundej... e pastaj

ata do ta mësonin që ai të kuiste si një këlysh qeni, ndryshe ai do të çmendej, do të bërtiste, do t'u thoshte: «Mjaft më, tani do t'ju tregoj gjithçka, s'kam pér të fshehur... Mbarova... vdiqa... po më jepni penën të nënshkruaj dhe më lini të qetë, më lini të ulem, të fle, të mjekoj plagët që më dhembin... kaq dua».

Dhe ata prisnin, ah, sikur ta bënte këtë, atëherë ai nuk do të ishte më një shkëmb, por një hiç, një grusht pluhur e ata do të dinin si ta fshinin nga faqja e dheut! Por jo, ata èndërronin më kot... Shkëmbi buzëqeshte, ndërsa sytë i mbante të mbërthyer mbi dritaren e myllur.

«Nesër do të lindë përsëri dielli. Jeta do të nisë... fëmijët do të vrapijnë të lozin udhëve të qytetit duke zhurmuar. Ndërsa në male... atje luftohet. Po, po. Luftohet... Ai nuk ishte vetëm, shokët e tij... Partia, i tërë vendi ishte me të, më presin...» dhe buzëqeshi. Po vjen pranvera, mendoi, do çelë së pari kumbulla, ujërat do të varen vrullshëm nga mali e toka do të ngrohet, mbase do të ngrohem dhe unë... mbase... Sido që të jetë, unë...»

I dhembnin tabanet e këmbëve aq sa mezi e mbanin, koskat i thernin e dhembja i depërtonte deri në tru. «Mbahu, mos e humb ekuilibrin, atë duan ata, mezi e presin atë çast.»

Ndjeu se po i merreshin mendtë, por e mblo-dhi shpejt.

— E, djalë, a do të flasësh? Më thonë Xhafë mua! E more vesh? Xhaafë! Të marr shpirtin, shpir... Poshtë të pret bodrumi, e di, e kam freskuar me ujë... hi-hi-hi, dhe kamxhiku... por na dhe një këtu. — Këtë herë e qëlloi me grusht dhe qeshi.

Tjetri e vështroi i heshtur, një çurkë e re gjaku iu përhap mbi fytyrë. Lëvizi paksa buzët dhe një pështymë e kuqe fluturoi në ajër, qëndroi pezull dhe u ngjit mbi surratin e shtypur të kapterit. Bulldogu u mpi, nuk e priste këtë, nuk ia mori mendja.

Këmbët e karriges gërvishën dyshemenë me zhurmë. Ishte Janaqi që kërkonte të ngrihej, ashtu shkurtalaq e thatuq ai ishte mbledhur edhe më shumë e ishte bërë sa një grusht, aq i vogël... i vogël si një zhapi. Diç deshi të bënte apo të thoshzte, por ra mbi tryezë dhe e zu gjumi. Kur hapi sytë, pa se drita e mëngjesit po e çirrte dalngadalë terrin e natës. E urdhëroi Xhafën të shkonte e të rregullonte «vendin». Bulldogu u largua dhe ata mbetën përsëri vetëm. Dy skaje të kundërta. I kuqi, ngaqë gjaku i kishte larë fytyrën, qëndronte i lidhur në këmbë, ndërsa shkurtabiqi si zhapi me sy të blertë kishte shtrirë trupin mbi tryezë. Dukej se e ndjente veten të lodhur. «Që thua ti, a flet murri? Aq foli dhe ky njeri, e tashti gjithçka mori fund! Tani do të marrë fund gjithçka, ose do fliste, ose... Ishte bërë gati gjithçka. «Veglat e punës» qenë ekspozuar nëpër faqet e murit të bodrumit të errët. Ai i kishte provuar dhe s'qe thyer. Do t'i provonte dhe një herë tanë... pastaj le të shohim.

Thellë në ndërgjegjen e tij zvaranikun e gërryente një dyshim, ai e merrte me mend se përsëri nuk do të kishte sukses, nuk do i dëgjonte mburjet e shokëve, të shefave... Jo, djaloshi nuk do të fliste. Ktheu kokën dhe vështroi mbi të. «Sytë e djaloshit janë zmadhuar nga dhembjet» mendoi gjarpri. Por s'qe ashtu.

Djaloshi hodhi sytë nga dritarja. Iu duk sikur

në murin e lyer me gëlqere të bardhë, atje përballë, dikush kishte shkruar me shkronja të mëdha, të kuqe: «V.F.L.P.» I puliti disa herë qepallat e rënduara si të mos besonte, por jo, parulla ishte po aty, ajo ishte shkruar sonte pra! Dhe e ndjeu veten të qetë. Zuri të mendonte, por mendimin ia preu në mes një e goditur. Dora ishte e rëndë, kish-te qëlluar bulldogu.

Tashmë në qiel qjet ishin shuar dhe drita e diellit pak nga pak po përqafonte qytetin. Hyri kapteri.

— Gati gjithçka, zoti toger.

— E pregatite mirë, ë? Ti je i zellshëm, Xhafë, prandaj do të propozoj të të gradojnë.

Nga këto fjalë bulldogu e hapi gojën vesh më vesh duke i zbuluar përsëri ata çatallët e tij, në shenjë falënderimi.

— Mirë, pra, meqë unë jam i lodhur, merrti me të.

— Si urdhëron! — dhe takat u rrähën përsëri me njëra-tjetërën.

Uniforma e zezë i lidhi duart prapa kurrizit e nisi eçejakun e dëshpëruar. Dëshpërimi i tij kishte arritur kulmin. «Ky kokëgdhë, ky i mallëkuar po më prish tërë karrierën e bukur që më priste, të-rë...» U kthye dhe e pa. Ai qëndronte aty, përrpara tij, më këmbë, ashtu i madh, i heshtur dhe me atë buzëqeshjen përcmuese. Vështrimet e tyre u ndeshën përsëri. Eprorët i kishin premtuar grada, para, pushime në Itali, por vetëm me një kusht, të nënshtonte të kuqtë! Tashmë u bind se s'do të kishte asnjë nga këto, ndaj ndjeu ta pushtonte zemërimi dhe thirri:

— Merre, Xhafë, dhe nxirria shpirtin!

— Shkojmë, «xhan» — dhe bulldogu i rrahu lehtë supet njeriut të lidhur.

Djaloshi eci drejt derës dhe për një kohë të gjatë nëpër shkallë ushtuan zinxhirët. Gjarpri i lodhur, i mundur, u ul në karrige e, si e ngjeshi qafën e tij të hollë brenda jakës së uniformës së zezë, u mblodh kutullac.

LULISHTARI PLAK

Në qytetin tonë të vogël e vëtmja gjë e bukur ishte një lulishtë. Në njërin cep të saj ishte ndërtuar një barrakë ku jetonte i vëtmuar lulishtari plak. Nga trupi vinte i shkurtër e me shpatulla të ngush-ta. Fytyrën e kishte të hequr dhe të mbushur me vija të thella rrudhash. Kishte dy sy të vegjël të zes dhe mjaft të lëvizshëm. Ai jetonte me lulet; lulishtja nuk ishte aq e gjerë dhe ishte e ndarë në parcela të vogla. I dridhej zemra kur vinte vjesta dhe gjethet fillonin të vyshkeshin. Ai gjithë merak ngrihej që pa gdhirë dhe fillonte t'i krasiste deri në perëndim të diellit.

Edhe për lulishtarin plak qëllonin ditë të lum-tura. Fytyra i ndriste nga gjëzimi, kur i dhuronte ndonjë çifti të ri një buqetë me lule, e kjo ndodhë ngaqë ndoshta ai, në jetën e tij, nuk e kishte pruvuar gjëzimin e prindit. Ajo ditë i dukej e jashtë-zakonishme. Qeshte e bënte shaka, hynte në pijetoren aty pranë dhe ashtu shpejt, më këmbë, i rrë-këllente nja dy gota. Trupi i plakur i përtërihej, në qenien e tij ndjente një gjëzim që s'kishte të

përbajtj. Pastaj dita e lumtur mbaronte e ai mbyllej përsëri në veten e tij, pa ditur se ç'ndodhë jashtë mureve të lulishtes.

Dikur, në rininë e tij, edhe ai kishte dashruar, por në heshtje, se vajza nuk i ishte përgjigjur. Ai e kishte fshehur atë kujtim të largët e gjithnjë ndjente mall.



Më shumë nga të gjitha lulet ai donte trëndafilen. Edhe vjollcat i pëlqenin, por ato ishin më delikate, si ato vajzat e turpshme, kurse trëndafili ishte krenar, pak i egër me atë ngjyrën e ndezur. Lulishtari plak ngrivej pa lindur dielli dhe priste me durim derisa të shpërthenin gonxhet dhe të hapeshin petalet e kuqe, si të priste lindjen e një fëmije. Pastaj buzëqeshte, sytë e vegjël i zbuteshin dhe fillonte e i përkëdhelte lehtë me ato duart e tij të ashpra.

Ditët dhe muajt kalonin pa ngjarje në jetën e lulishtarit plak. Ai ishte zhytur thellë në botën e luleve, në atë botë të heshtur e që për të ishte gjithçka. Ai kishte harruar se jashtë botës së tij bëhej luftë, se qyteti tij i vogël, me ato rrugë të shtrembra e i rrethuar nga malet, i ngjante një zjarri të nëndheshëm. Por edhe në botën e tij të luleve, në atë botë që ai e donte me afshin e një dashnori, hyri edhe lufta.

Ishte ditë pranverë atëherë kur e thirrën në komandaturë. Ata, oficerët e huaj, e priten mirë. I dhanë cigare, i mbushën një gotë me verë dhe i ranë shpatullave. Trupi i tij i imtë humbi në atë rreth njerëzish të huaj. Ngjyra e verës i solli për një çast ndër mend trëndafilët. Pastaj i mbylli systë, e tundi shpejt kokën dhe ra në një dëshpërim të thellë. Por njerëzit zhurmonin dhe ai erdhi përsëri në vete e filloj të buzëqeshte me zor, kur ata i flisnin me atë gjuhën e tyre të ashpër.

— Ti, një tufë lule. Nesër mbrëma. Komandanti ynë, datëlindje, kuptoj?

— Aha, e mora vesh — iu përgjigj plaku dhe mori të dilte.

Pas kurrizit të tij dëgjoi përsëri të qeshura.

«Ata kërkojnë një buqetë me lule, mendoi plaku ndërsa zbriste shkallët e drunjta të komandaturës. Duan të zbulukurojnë tryezën e gostisë. Pastaj do të bëjnë një fotografi në shenjë kujtimi për datëlindjen e të parit të tyre. Në mes të tryezës do të vendosin një vazo të bukur, të sjellë kushedi se nga ç'anë dhe të stolisur me lulet e mia. Një tufë me lule! Atë mund ta gjejnë me lehtësi në lulishthen time, edhe diku gjetkë, në qytet. Madje ata, për këtë tufë me lule mund ta kthejnë përbys tërë lulishten time. Po nderin tim a mund ta kthejnë dot përbys?»

Kështu mendonte lulishtari plak në heshtje, pastaj, duke e ngritur zërin pa e kuptuar as vetë, buçiti:

— Nderin tim e kam vetë në dorë, ju sot përsot keni vetëm lulishten!

Mbi kokën e zbardhur të plakut rëndonin mendimet. Në rrugët me kaldrëm të qytetit rrridhte e qetë jeta. Pemët tundeshin të veshura me gjelbërim, fëmijët lozni me zhumë, përroi rrridhte nën urën me dërrasa. U end rrugëve, derisa në qytet ra muzgu i mbrëmjes, pastaj nxitoi për një lulishte. Hyri në barrakë dhe ashtu, i lodhur, u ul. Atë çast kishte vetëm një dëshirë, të kishte një njeri pranë, të kuvendonte me të, të këshillëhej, t'i tregonte gjithçka që i buçiste si dallgë deti brenda atij kraharoni koskë e lëkurë. Për herë të parë e provoi ashpër atë ndjenjë të padurueshme të vëtmisë. I erdhi keq që kishte qëndruar aq larg njerëzve. U inatos me atë botën e tij të vogël, që po tregohet e pamëshirshme në ato çaste të vështira. Iu kujtua Nesti, ai djali i qeshur që i vinte ditëve të diela në lulishte. Të paktën ta kishte atë pranë

tani, por edhe Nestin e vranë. E vranë ata që i kërkuau lule, atje, në komandaturë. E donte shumë atë djalë. Edhe ai s'kishte njeri. Dhe sa bukur i thërriste djali, xhaxha! E vranë qentë, e vranë se ai ishte komunist! Për këtë e vranë.

Lulishtari plak psherëtiu.

— Nuk u jap lule atyre — tha dhe i ra gjurit me grusht. — Jo! Nestit po, atij do t'i dhuroj një buqetë me lule. Nesër në mbrëmje do t'ia vendos mbi varrin e tij.

Me këto mendime u shtri për të fjetur.

Të nesërmen, si çdo ditë, punoi në lulishte. I vështronte me radhë vjollcat, zambakët, karafilët, iu afrua trëndafilëve. U ul në gjunjë, i preku me dorë. Një gjemb i shpoi gishtin. Plaku buzëqeshi.

— He! — i tha. — Më gudulise. I bukur je, i bukur, si Nesti, i qeshur dhe krenar si ai. Eh, kjo pleqëri! Më dhemb diçka, ja këtu — e plaku i tregoi trëndafilit se ku i dhembte. Qëndroi për shumë kohë ashtu. I ra në sy një gjethë e vyshkur.

— Dale ta heq këtë gjethë, dua që ti të jesh i pastër si Nesti — i tha dhe e ngriti lart gishtin tregues, sikur këshillonte njeri.

Në mbrëmje, kur mbaroi punë, hyri në barrantë. Hapi një arkë të vjetër dhe prej andej nxori një palë rroba të reja.

«Të shkoj i pastër te Nesti. Ai do të gëzohet!»

U ndërrua me kujdes, vuri në kokë kasketën dhe doli. Në qìell vezullonin yjet. Hëna apo kishte dalë dhe një erë e lehtë i freskoi fytyrën. I ra edhe një herë rrëth lulishtes, shëtit i qetë me duar prapa. U afrua te trëndafilët. U kërrus dhe filloi të këpuste. Iu kujtua se në atë kohë e prisnin edhe

oficerët e huaj. Tryeza ishte gati, vetëm lulet mungonin.

«Bravo, plak, do t'i thoshin. Merri këto të holla, piye një dolli pér shëndetin e komandantit, pér lavdinë e ushtrisë sonë.»

Te këmbët do t'i hidhnin një grusht me monedha. Do të ulej t'i mblidhëtë vallë? Ishte njësoj sikur t'u puthte çizmet. Ata do të gajaseshin, do të qeshnin me lot, do të talleshin me thinjat e tij Jo! Ai gjithë jetën kishte jetuar si një njeri i ndershëm, nuk ishte hequr zvarë. Një vlagë e nxehëtë ia përshkoi trupin. Shtrëngoi nofullat. Tëmthat i rrighnin. I erdhi ndër mend kosorja që mbante varur aty, në barrakë. Sytë i ndritën. Një mendim i përshkoi trurin.

— Do t'i korr. Do t'i shkel me këmbë. Ata të mos marrin asnje gjethë!

Hëna vazhdonte të ndriste e zbetë dhe e ftohtë. Në rrugicat e lulishës zgjateshin konturet e pemëve. Një zog nate ia kishte marrë me zë të zgjatur si në vajtim. Lulishtari plak hodhi sytë nga malet, ato u shëmbëllënин hijeve vigane e plakut iu duk sikur nga malet po zbrisnin me pushkë në krah djemtë, ashtu siç zbrisnin në rininë e tij komitetët.

Tufën e trëndafilëve e la aty mënjanë. Hyri në barangë dhe mori kosoren. E provoi nëse priste dhe doli jashtë. Qëndroi disa minuta në këmbë, pa vendosur nga t'ia fillonte. Për të gjitha i vinte keq. Gjithë jetën e kishte kaluar në atë Julishtë, i kishte rritur ato lule, ishte kujdesur pér to, si prindi pér fëmijët. Cdo rrënje i dukej e shtrenjtë. Ishte gëzuar dhe hidhëruar së bashku me to, madje kishte kuvenduar me to, si me shokët. Dhe sa

njerëz ishin gëzuar nga lulet e tij, sa djem dhe vajza stolisën me këto lule rrobat e nusërisë. Dhe tani kjo lulishte do të merrte fund.

Faqet e vyshkura iu lagën, ai nuk kishte qarë kurrë në jetën e tij, as atëherë kur e la në mes të rrugës dashuria. Lagu me pështymë pëllëmbët e duarve dhe filloj të kositte me térbim. Lulet binin pa jetë në këmbët e tij e plaku, si i priste, i shkelte.

— Merrni lulet! — thërriste ai. — Festoni datëlindjen, pini, bëni qejf, djersën time nuk e gëzoni dot. Ha! Ha! Ha! Më prisni, zotërinj oficerë, erdha, ja edhe pak! — fliste me vete lulishtari plak dhe hapte krahan sa i hante. «Fësh, fësh, fësh,» fëshférinte kosorja me zë të hollë.

Hëna e zbetë dhe malet përreth ishin spektatorët e vetëm të kësaj tragedie. Në qenien e tij ishin përzier urrejtje e dashuri bashkë.

Mbas pak kohe gjithçka kishte marrë fund. Plaku, si fshiu ballin e djersitur, i hodhi një vështrim asaj që kishte bërë dhe mori buqetën me trëndafilë, u nis.

— Tani do të shkoj i qetë te Nesti!

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

Fundi i një rruge	3
Pulëbardhat.	16
I shtiruri	22
Thjeshtësi	31
Violina e heshtur	36
Kujtime fëmijërie	43
«V.F.L.P.»	47
Lulishtari plak.	57